

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0597*****Në ankesën e******Paditësja*****H(A)S, Prishtinë  
kundër*****E paditura/Ankuesja***

**NSH. "Marketing Export"**, (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili, dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2381 të datës 28 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 tetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditurës pjesërisht është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet pika 2 e dispozitivit të Aktgjykimit Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2381 të datës 28 shtator 2022, në vend të shumes prej 3.600,00 euro, e paditura obligohet ti paguaj paditëses shumen prej 1.620,00 euro, për periudhën nga muaji janar 2009 e deri në**

**dhjetor 2011, e cila shume do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.**

**3. Pjesa tjetër e dispozitivit të Aktgjyimit të ankimuar, vërtetohet.**

**4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 7 prill 2014, paditësja e dorëzoi në DHPGJS- një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN096-0158, të datës 26 mars 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditëses e datës 10 shkurt 2014 për pagesën e pagave të pa paguara për periudhën prill 2003-dhjetor 2011 në shumë të pa përcaktuar, nga NSH "Marketing Export" në Prishtinë, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së bashkuar.

Paditësja në ankesë pohon se Autoriteti i Likuidimit gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe si rrjedhojë e kësaj gabimisht ka aplikuar edhe dispozitat materiale. Tutje ajo pohon se NSH-ja e paditur në bazë të nenit 368 të LMD-së e ka pranuar borxhin në bazë të shkresës të muajit dhjetor 2011 dhe se ajo ka të drejtë në pagat e pretenduara ndaj NSH-së. Bashkë me ankesë paditësja ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN096-0158 të datës 26 mars 2014, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies se punës me datë 19 janar 2012, një vërtetim të përvojës se punës lëshuar nga AKP-ja me datë 28 janar 2014, formularin e kërkesës dorëzuar të Autoriteti i Likuidimit dhe kopjen e letërnjoftimit.

Me datë 12 dhjetor 2016, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtën në ankesë. Në mbrojtën në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të sakte të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se ankesa e paditëses nuk i përmbush kriteret e pranushmerise nga neni 70.2 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Paditësja në ankesën e saj nuk ka saktësuar se cili neni i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e

Autoriteti të Likuidimit. Tutje AKP-Ja pohon se kërkesa për paga për periudhën prill 2003 –dhjetor 2011 është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës se Bashkuar, pasi që paditësja nuk ka ofruar dëshmi për të vërtetuar se këto paga i ka kërkuar brenda 3 viteve tek Gjykata Kompetente .Nga këto arsyeje AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 29 dhjetor 2016,paditësja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në mbrojtën në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtresë ,ajo i kundërshton pretendimet e AKP-së se kërkesa është parashkruar dhe kërkon nga Gjykata që asaj të i njihet e drejta në kompensimin e pagave për muajit prill 2003 e deri në 19 janar 2012 në shume prej 12.449,92 euro .Bashke me këtë parashtresë ajo dërgon një kopje të një ankesë të datës 22.09.2014 ,një regjistër të punëtorëve ,kopjen e ankesës dorëzuar në Shkallen e I-rë të dorëzuar 07 prill 2014 si dhe provat e mëhershme të dorëzuara me ankesë në Shkallen e I-rë.

Me datë 17 janar 2017,AKP-ja e dorëzoj në DHPGJS kundërpërgjigjen ,në të cilën ajo i përsëritur pretendimet e veta të cekura në mbrojtjen në ankesë.

Me datë 30 mars 2022,Shkalla e I-rë e DHPGJS e ka lëshuar një urdhër për paditësen me të cilën janë kërkuar prova shtesë në mbështetje të ankesë si dhe ka kërkuar një vërtetim se cila ishte paga mujore e saj në kohën e largimit nga puna e shprehur në vlerën në euro.

Me datë 15 prill 2022,paditësja e dorëzoj në DHPGJS një parashtresë si përgjigjje ndaj urdhrit. Në këtë parashtresë ajo pohon se nga muaji tetor i vitit 1999 e deri në muajin mars 2003 ajo është paguar nga NSH-ja me 150DM në muaj e pastaj 100 euro ,me vone 50 euro dhe dikur edhe me vone 45 euro, duke pohuar se më varësisht se sa ka pasur të ardhura nga qira janë paguar punëtorët .Ne këtë parashtresë ajo pohon se nga muaji prill 2003 e deri me 19 janar 2012 nuk është paguar asnjë cent nga ana e AKP-së. Me këtë parashtresë ajo ofron listat e pagave për periudhat të cilave ajo u referohet në këtë parashtresë.

Me datë 28 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV.-14-2381 e aprovon ankesën si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoriteti të Likuidimit dhe e obligon AKP-në që të i paguaj paditëses pagat e pa paguara për periudhën 19 janar 2009-19 janar 2006 në shume prej 3.600,00 ,që do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nuk është kontestues fakti se ankuesja ishte punëtoare e NSH "Marketing Export" në Prishtine, por kontestuese mbetet çështja e parashkrimit të kërkesës për pagat e pa paguara .Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësja për vitet 2001,2002,dhe 2003 ka pranuar shuma të ndryshme të hollave në emër të pagës me varësisht se sa NSH-ja ka fituar të ardhura nga qiratë e paguara për lokalet e ndërmarrjes. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se lista e pagave të paguara e ofruar nga paditësja për vitet 2001,2002,2003 është marrë për bazë edhe kur është aprovuar kërkesa e saj për periudhën nga 19 janar 2009 e tutje. Shkalla e I-rë konstaton se me rastin e aprovimit të shumes 3.600,00 euro është bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga palët përlllogaritur pagat për 3 vite duke marrë për pike referuese datën e njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies se punës me 19 janar 2012, kështu që për cdo muaj ka përcaktuar shumën prej 100 euro dhe për 36 muaj ,ankueses i është njohur e drejta në shume prej 3.600,00.Shkalla e I-rë konstaton se pjesa e kërkesës përtej shumes se aprovuar është refuzuar për faktin se ankuesja nuk ka ofruar dëshmi se pagat e kërkuar nga muaji prill 2003 e në vazhdim të i këtë kërkuar në Gjykatën kompetente brenda 3 viteve. Shkalla e I-rë po ashtu konstaton se ankuesja me një parashtese të saj e ka sjell vendimin e Autoriteti të Likuidimit PRN-096-0010 të datës 26.08.2014 sipas të cilit shuma prej 12.449,92 euro ishte refuzuar në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës se punës, dhe ky vendim nuk është marrë për bazë pasi që paditësja nuk e ka ankimuar në ankesën e saj në Shkallen e I-rë.

Në bazë të fletë dorëzimeve që ekzistojnë në dosje, të dy palët Aktgjykimin e Shkallës se I-rë të DHPGJS-së e kane pranuar me 10 tetor 2022.

Me datë 20 tetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon një Aktvendim C-IV-14-2381 me të cilin e korigjon Aktgjykimin C-IV.-14-2381 të datës 28 shtator 2022, ashtu që një pjesën e dispozitivit në pikën 2 në vend të datës **19 janar 2009 -19 janar 2006** duhet të jete **19 janar 2006-19 janar 2009**, si dhe në pjesën e arsytimit ligjor në rreshtin e parë ku thuhet **“Ankesa refuzohet si e pa bazuar”** duhet të jete **“Ankesa aprovohet si e bazuar”**, ndërsa në faqen e katërt të Aktgjykimit në pasuesin e dyte, rreshti i gjashte në vend të datës **28.01.2014** duhet të jete **28.01.2014**. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se i ka vërtetuar lëshimet teknike lidhur me data dhe vitet e njohjes e kompensimit, dhe ka bërë përmirësimin e këtyre lëshimeve, dhe po ashtu lëshimet janë evituar edhe në pjesën e arsytimit ligjor.

Në bazë të flete dorëzimeve që ekzistojnë në dosje, Aktvendimi korigjues, C-IV.-14-2381 i datës 20 tetor 2022, iu është dorëzuar AKP-ja me 21 tetor 2022, dhe paditëses 24 tetor 2022.

Me datë 24 tetor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2381 të datës 28 shtator 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit, dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja pohon se me Aktvendimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore të dhëna në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe në mbrojtjen në ankesë. Tutje AKP-ja pohon se gjetjet faktike të gjykatës janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes dhe plotësisht të pa bazuara në ndonjë dokument që ekzistojnë në dosje të lëndës. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme, njëra që ndërlidhet me afatin për parashtrimin e kërkesave i cili afat i përket procedurës së dorëzimit të dëshmisë së kërkesës dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën ( meritat e të drejtës e që ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kërkesës e që në këtë rast

është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së Bashkuar. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dërguar tek paditësi ka pas për qëllim të informon atë se ai ka të drejtë të parashtroj kërkesë pranë AKP-së dhe se ky njoftim nuk i mbron të drejtat e tij dhe nuk siguron mjete ligjore që ai ka në dispozicion. AKP-ja pohon se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes nuk ka marr parasysh faktin se paditësi nuk ka qenë në Listën e pagave për periudhën e cekur. Tutje AKP-ja në ankesë pohon se paditësi nuk ka saktësuar cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur, duke pohuar se DHPGJS-ja ka kompetencë të shqyrtoi vetëm ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se gjykata duhet të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të marrë në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 08 nëntor 2022, AKP-ja e ka dorëzuar edhe një parashtresë në DHPGJS lidhur me lenden C-IV.-14-2381. Në këtë parashtresë ajo pohon se e ka pranuar me datë 21 tetor 2022, një Aktvendim korrigjues të Shkallës së I-rë me të cilin është korrigjuar Aktgjykimi C-IV.-14-2381 të datës 28 shtator 2022, në mënyrë siç është cekur në dispozitiv të këtij Aktvendimi. Andaj me këtë parashtresë Gjykatës ia përcjell edhe këtë Aktvendim korrigjues i cili nuk ka ndryshime permabjtësore. Bashke me këtë parashtresë ai dorëzon kopjen e ankesës të dorëzuar në Shkallen e II-të dhe kopjen e Aktgjykimit të ankimuar.

Me datë 05 dhjetor 2022, paditësja e dorëzoj një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë ajo pohon se i kërkon pagat e pa paguara për tete muaj të vitit 2003, për tërë vitin 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, pasi që nuk janë paguar, kështu që numri i pagave të pa paguara është për 104 muaj. Tutje ajo pohon se marrëdhënia e punës i është ndërprerë në NSH në janar të vitit 2012, dhe ky fakt nuk është kontestuar nga AKP-ja. Ajo pohon se në korrespondencën e deritashmishme me Gjykatën ajo i dorëzuar provat e nevojshme.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e AKP-së është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, duhet të ndryshohet në pikë **2** të dispozitivit ashtu që në vend të shumës 3.600,00 euro sa është e cekur si shume e aprovuar në këtë pikë ,duhet të jetë shuma prej 1.620 euro, që duhet të paguhet në emër të pagave të pa paguara për periudhën nga muaji janar 2009 e deri në muajin dhjetor 2011.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me datë 10 shkurt 2014 ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ajo ka kërkuar të paguhet pagat e pa paguara për periudhën prill 2003-dhjetor 2011 nga NSH“Marketing Export” në Prishtinë, në një shume të pa përcaktuar. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me ankesën e saj të dorëzuar me datë 07 prill 2014 ndaj vendimit të cekur të Autoritetit të Likuidimit, nuk e përcakton shumen konkrete që ajo e kërkon në emër të pagave të pa paguara për periudhën e cekur. Me këtë ankesë ajo ka bashkangjitur: vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN096-0158 të datës 26 mars 2014, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies se punës me datë 19 janar 2012, një vërtetim të përvojës të punës lëshuar nga AKP-ja me datë 28 janar 2014 ,formularin e kërkesës të dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit dhe kopjen e letërnjoftimit.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësja me parashtrësën e saj të dorëzuar në DHPGJS me datë 29 dhjetor 2016 si përgjigje ndaj mbrojtjes në ankesë, ajo ka kërkuar pagat e pa paguara prej muajit prill 2003 e deri më 19 janar 2012 në

shume prej 12.449,92 euro, të cilat ajo pretendon se asaj duhet të i njihen si kompensim për ndërprerje të marrëdhënies se punës. Me këtë parashtrësë ajo dorëzon të njëjta prova që i ka sjell me ankesë.

Kolegji i Apelit vëren se me Njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies se punës me datë 19 janar 2012, vërehet se me këtë provë ajo e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës për një pjese të periudhës se pagave të papaguara të cilat i kërkon paditësja ndaj NSH-së në likuidim.

Duke marrë për bazë faktin se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës me 19 janar 2012, atëherë del që pagat nga muaji janar 2009 e deri muajin dhjetor 2011, nuk mund të konsiderohen si të parashkruara, pasi që ky njoftim e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit. Ndërsa pagat tjera të periudhës se mëhershme nga muaji prill 2003 e deri në dhjetor 2008 janë parashkruar, dhe lidhur me këtë pjese të kërkesës Kolegji i Apelit pajtohet me konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë me Aktgjykimin e ankimuar të datës 28 shtator 2022, konsideron se pagat e periudhës 19 janar 2009-19 janar 2006 në shume prej 3.600,00 nuk janë parashkruar, andaj vendos që ta aprovoj këtë shume në emër të pagave të pa paguara. Me datë 20 tetor 2022, shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon një Aktvendim korrigjues, C-IV-14-2381 me të cilin e korrigjon Aktgjykimin C-IV.-14-2381 të datës 28 shtator 2022, ashtu që një pjesën e dispozitivit në pikën 2 në vend të datës **19 janar 2009 -19 janar 2006** duhet të jete **19 janar 2006-19 janar 2009**, si dhe në pjesën e arsytimit ligjor në rreshtin e parë d\ku thuhet **“Ankesa refuzohet si e pa bazuar”** duhet të jete **“Ankesa aprovohet si e bazuar”** , ndërsa në faqen e katërt të Aktgjykimit në pasuesin e dyte, rreshti i gjashte në vend të datës **28.01.2014** duhet të jete **28.01.2014** .Shkalla e I-rë ka arsyetuar se i ka vërejtur lëshimet teknike lidhur me data dhe vitet e njohjes e kompensimit, dhe ka bërë përmirësimin e këtyre lëshimeve, dhe po ashtu lëshimet janë evituar edhe në pjesën e arsytimit ligjor.



Kolegji i Apelit nuk e mbështet as këtë korrigjim të bërë lidhur me periudhën e pagave të aprovuara dhe as shumën e aprovuar në pikën e 2 të dispozitivit të Aktgjykimin fillestar.

Nuk është i sakte konstatimi i Shkallës së I-rë se pagat nga 19 janar 2006 deri në 19 janar 2009 nuk janë parashkruar, kjo për faktin se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës është i datës 19 janar 2012 dhe në bazë të këtij njoftimi, nëse kthimi bëhet tri vite më përpara sa është afati i parashkrimit të kërkesës, del që pagat e kërkuara nga data 19 janar 2009 e deri në dhjetor 2011, nuk janë parashkruar ndërsa për periudha paraprake kërkesa për paga është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja në parashtresën e saj të datës 15 prill 2022, të cilin e kishte dërguar në Gjykatë si përgjigje ndaj urdhrit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së të datës 30 mars 2022 për të dërguar prova shtesë, ajo vet ka pohuar se paga e fundit që është marrë nga NSH-ja në bazë të të ardhurave të fituara nga qiraja e lokaleve të ndërmarrjes e muajit mars 2003 ishte vetëm 45 euro, ndërsa paraprakisht kishte marrë edhe shumën tjetër në vlera më të mëdha në DM(marka). Këto pohime të cekura me këtë parashtresë ajo i ka mbështetur edhe me listat përkatëse të NSH-së të viteve përkatëse.

Andaj duke u bazuar në këto pohime të vet paditëses dhe në këto lista të cilat ajo i ka dorëzuar me këtë parashtresë, Kolegji i Apelit ia njeh të drejtën paditëses në paga të papaguara për periudhën janar 2009 e deri në dhjetor 2011, dhe atë duke marrë për bazë pagën e fundit mujore të marrë nga NSH-ja, në lartësi prej 45 euro. Kjo pagë prej 45 euro kur kalkulohet për 36 muaj, atëherë del që ajo ka të drejtë të iu aprovohen pagat e pa paguara në shumë prej 1.620 euro. Kjo shumë e aprovuar duhet të paguhet nga Autoritetit i Likuidimit sipas prioritetit të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e ka aprovuar pjesërisht ankesën e AKP-së si të bazuar, e ka ndryshuar pikën **2** të dispozitivit të Aktgjykimin të ankimuar dhe

e ka detyruar AKP-në që të i paguaj paditëses në emër të pagave të pa paguara për periudhën janar 2009-dhejtor 2011 shumen prej 1.620 euro.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 23 nëntor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 26 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_